

V E N D I M
Nr.75, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPERISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtare e “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 5.7.2001 dhe 7.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.80 Akti që i përket:

KËRKUESE:MAKBULE ÇEÇO, kandidate për deputete e Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. ROLAND BEJKO, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar nga juristi Vladimir Mulaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.984, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkujeses, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.984, datë 29.6.2001, ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.89, duke mos njohur fitues asnjë kandidat për deputet, si dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në këtë zonë në datën 8 korrik ndërmjet kandidates për deputete të Partisë Socialiste zonjës Makbule Çeço dhe kandidatit të koalicionit “Bashkimi për Fitore” zotit Roland Bejko.

Kërkuësja ka pretenduar përpara kësaj Gjykate se në raundin e parë të zgjedhjeve janë evidentuar mjaft parregullsi dhe shkelje ligjore në qendrat e votimit nr. 23, 24 dhe 25 të Komunës së Lazaratit.

Shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese dhe verifikimi i pretendimeve të palëve në proces, që lidheshin kryesisht me hapjen e kutive të votimit, listat e zgjedhësve dhe falsitetin e tyre, ka qenë objektivisht i pamundur që të përfundonte përpara datës 8 korrik 2001, datë e cila ishte caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të zhvilluar raundin e dytë të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.89.

Pas zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.89 ka shpallur fituese kandidaten për deputete të Partisë Socialiste zonjën Makbule Çeço.

Kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes kundër vendimit nr.984, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se çështja duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja “e” të Kushtetutës, si dhe në nenet 1, 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.